

PICASSO KINDER EC31



PËRSHKRIMI

Bojë plastike ekologjike pa aromë për përdorim të brendshëm për dhoma fëmijësh

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Bardhësi superiore
- Gjendet në 4 baza W, P, D dhe TR
- Punueshmëri dhe nivelim i shkëlqyer
- Ngjitje shumë e fortë dhe tharje e shpejtë
- Rezistencë të lartë ndaj larjes së shpeshtë
- Pranon 5000 cikle larjesh 30 ditë pas aplikimit
- Mbulueshmëri shumë e mirë dhe sipërfaqe të lëmuar mat
- Ngjyra të shkëlqyeshme e të qëndrueshme për një kohë të gjatë

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Përdoret në të gjithë muret dhe tavanët e brendshëm, të rinj, të vjetër dhe të lyer më parë me bojë, me bazë çimento, gëlqere, gips, sidomos dhoma gjumi për fëmijë, kopshte, shkolla, ambiente qendrash shëndetësore etj.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	PVA VEOVA Polimer
Densiteti EN ISO 2811-1	1,45±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	65%
Shkalla e hollimit	10 – 15%
Viskoziteti	110 ± 5 KU
Koha e tharjes mes dy shtresave	2 - 4 orë
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 1
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≤ 0.05
Aftësia mbuluese EN ISO 6504-3	≥ 99.5% Klasa I
Rezistenca ndaj larjes ISO 11998	Klasa I

UDHËZIME APLIKIMI

- Metoda e aplikimit: Furçë, rrul ose me sprucim.
- Hollimi: Rekomandohet të hollohet me 10-15% ujë përveç bazave D dhe TR që nuk sugjerohen të hollohen më shumë se 5% ujë.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet duhet të jenë të thara plotësisht, të pastra dhe pa elemente që pengojnë ngjitshmërinë e bojës. Riparoni të gjitha plasaritjet dhe pjesët e dëmtuara duke përdorur produktet e linjës Deutschcolor, Vox 707, Glatte Spachtel, Spachtel Finish, etj. Më pas rekomandohet të aplikohet astar Macht Tiefgrund Wasser, i holluar me ujë në raportin 1:1 ose astar Macht Haftgrund i holluar me ujë në raportin 1:3. Gjatë aplikimit të astarit evitoni krijimin e një cipe e cila më pas krijon probleme në lidhjen e bojës me suportin.

PAKETIMI

3 lt, 10 lt

RUAJTJA

36 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që sipërfaqet e lyera të mos lahen deri në 30 ditë pas aplikimit.
- Në sipërfaqe të betonit të freskët produkti rekomandohet të aplikohet të paktën pas 30-40 ditësh.

